



## Thirrje për artikuj dhe prezantime

Konferenca e 4 e Tekstilit

20 Nëntor 2010

Tiranë

Organizatorët e Konferencës së 4 të Tekstilit kanë nderin dhe kënaqesinë t'ju ftojnë të bëheni pjesë e kësaj konference që do të mbahet në datën 20 Nëntor 2010 në Tiranë.

Konferenca do të fokusohet në çështjet dhe problemet më të rëndësishme të shkencës europiane dhe globale në fushën e materialeve tekstile, teknologjive, dizenjimit dhe marketingut.

Për pjesëmarrësit në konferencën e 4 të Tekstilit Tirana do tu ofrojë atmosferë miqësore dhe kushte pune.

Presim të takohemi në Tiranë në Nëntor 2010!

Me përshëndetje miqësore,

Organizatorët e konferencës

Departamenti i Tekstilit dhe Modës

Universiteti Politeknik i Tiranës

### Çështjet kryesore

- Prodhim veshjesh
- Prodhim tekstili
- Biopolimerë dhe bioteknologji
- Rehati dhe mirëqënie
- Zhvillime në makineri tekstili
- E-aktivitete dhe E-tregti
- Ekologji dhe mjedsi në prodhimin e tekstileve
- Fizika e fibrave dhe Mekanika e tekstileve
- Përmbardim dhe ngjyrim
- Tekstilet me përdorim në mjekësi
- Modelim, stimulim
- Nanotekstilet
- Tekstilet inteligjente
- Logjistikë dhe Menaxhim
- Tekstilet teknike dhe mbrojtëse
- Dizajnimit dhe Modë
- Arsimimi në tekstil dhe modë
- Provat e tekstileve

Paraqitja e artikujve

### **Informacion i përgjithshëm**

Jeni të lutur të paraqitni dhe dorëzoni punimet tuaja për pjesëmarrje në këtë konferencë deri në datën 20 Tetor 2010.

### **Punimet dhe prezantimet duhet të paraqiten me anë të e-mailit në adresën**

[tatjana.spahiu@upt-tekstilmoda.org](mailto:tatjana.spahiu@upt-tekstilmoda.org) . Të gjithë artikujt e dorëzuar do të shqyrtohen nga Bordi i Konferencës. Bordi do të ketë të drejtën e klasifikimit të artikujve në postera ose prezantime gojore por do të jetë i gatshëm të plotësojë të gjitha kërkesat.

Prezantimet mund të jenë në dy formate:

- **Me gojë**
- **Me poster**

Të gjitha përmbledhjet e dorëzuara dhe pranuar do të botohen në një CD me punimet e Konferencës së 4 të Tekstilit.

### **Udhezues për autorët**

#### **Instruksione**

Autori duhet të tregojë preferencën për prezantim me gojë ose poster. Bordi i konferencës do të shqyrtojë të gjitha preferencat dhe kërkesat. Autorët do të njoftohen për pranimin e punimit të tyre.

#### **Udhezues për dorëzimin e punimit**

1. Të shkruhen emrat e autorëve:
  - 1.1. Të shkruhet kush do e prezantojë
  - 1.2 Renditen autorët sipas mënyrës që kërkohet të botohet
- 2.2 Abstrakti duhet të përcaktojë qëllimin, metodologjinë, rezultatet dhe konkluzionet e kërkimit/punimit (maksimumi 1 faqe)
- 2.3. Abstrakti duhet të jete në anglisht në format A4 me marzhe poshtë 3 cm, djathtas dhe majtas 2.5 cm.
- 2.4. Titulli jo më shumë se 70 karaktere;
- 2.5. Emrat e autorëve, institucioneve, shteteve dhe e-maillet duhen pas titullit të prezantimit

Ju lutemi të siguroheni që përmbledhjet të përshtaten me formatin e kërkuar në Microsoft Word ose Acrobat Reader.

Eshtë përgjegjësia e autorit që të kontrollojë artkullin për gabime gramatikore ose shkencore.

**Afati i fundit për dorëzimin e përmbledhjes së artikujve është data 15 Gusht 2010.**

**Afati i fundit i pranimit të punimeve është data 20 Tetor 2010.**